

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "SUN POWER" Sh.p.k.

Sot, më datë 29/06/2022,

- **"Wealthy Bee" Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS M11426012T, me seli në: Rruga "Gjin Bue Shpata", nr. pasurie 1/181/ND+N3, kati 2 (pranë ish-urgjencës), Tiranë, përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë, Z. Erdi Sakej.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "SUN POWER" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "SUN POWER" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Ismail Qemali, Pallati 11, Kati 2, në krah të Radio Televizionit Shqiptar, Tiranë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Projektim, zbatim, ndërtim të impianteve të prodhimit të energjisë me panele diellore;
- Shitja e energjisë elektrike për kliente të ndryshëm, shtet ose privat, të vendit ose të huaj;
- Shfrytëzim dhe mirëmbajtje të pajisjeve të paneleve diellore;
- Projektim, ndërtim dhe montim të pajisjeve dhe linjave të transmetimit të energjisë elektrike;

- Punime të ndryshme ndërtimore në funksion të objekteve dhe pajisjeve të gjenerimit dhe transmetimit të energjisë elektrike;
- Projektim dhe vlerësim gjeologjik, ambiental dhe tekniko-profesional në përgjithësi;
- Projektim zbatim dhe ndërtim i objekteve civile dhe industriale;
- Punime ndërtimore të terreneve, kanalizimeve bonifikuese, të rrugëve dhe të tjera, pa cënuar objektin kryesor të shoqërisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 1,000,000 Lek (një milion) dhe është i përbërë nga 1 (nje) kuote.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **“Wealthy Bee” Sh.p.k**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1,000,000 (një milion) Lek dhe 1,000,000 (një milion) Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Z. Evis Sopi**, shtetas shqiptar, lindur më 16/12/1977, në Shkodër, banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. Personal H71216102G madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Z. Evis Sopi** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

"WEALTHY BEE" SH.P.K

Përfaqësuar nga

Erdi Sakej

Erdi Sakej

